



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 276, Datë 27.10.2022

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY TRADE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “f”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1829/10 prot., datë 24.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1840 prot., datë 19.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/D

të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”, për pikën 1.3, gërma “c” dhe për pikën 2.5, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penaltetit) për shoqërinë dhe administratorin e saj.
- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse mbi numrin e administratorëve të saj dhe të sjelli informacion nëse është miratuar versioni final i organigramës së saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore.
- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE letrën e interesit të lëshuar nga banka, ku të referohet financimi për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkohet të licencohet, pra furnizimi me energji elektrike, ose të depozitojë vërtetim bankar për disponimin e kapitalit fillestar dhe mundësinë e përdorimit të kësaj shume për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Pika 2.5. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- **gërma “d”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi nivelin e tensionit që do të furnizojë klientët.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI